


Test për COVID-19



Danimarka është një nga ata vende në botë, që në krahasim me popullsinë teston më shumë persona. Është e rëndësishme të mbahet nën kontroll epidemia dhe presioni i infeksionit.

Në Danimarkë, ne testojmë si njerëzit me simptoma ashtu edhe njerëzit pa simptoma.

Simptomat e COVID-19 përfshijnë ethe, kollë, vështirësi në frymëmarrje, dhimbje koke, dhimbje të muskujve ose dhimbje të fytyrës.

Shkoni në shtëpi në izolim dhe qëndroni në shtëpi nëse keni simptoma

Nëse ndiheni të sëmurë dhe keni simptoma të COVID-19, bëni sa më poshtë:

- Shkoni në shtëpi dhe qëndroni në shtëpi derisa të të testoheni
- Testohuni - dhe mbani mend maskën e gojës
- Shkoni në shtëpi pas testit dhe qëndroni në shtëpi derisa të merrni përgjigjen.

Si të rezervoni takim për testim

Rezervoni një takim për testim në coronaprover.dk në situatat e mëposhtme:

- Ndiheni të shëndetshëm dhe nuk keni nevojë të flisni me një mjek, por gjithsesi dëshironi të testoheni.
- Keni simptoma të lehta të COVID-19, por nuk keni nevojë të flisni me një mjek.

Mos harroni se duhet të përdorni NemID tuaj, kur rezervoni një takim për një test në coronaprover.dk

Telefononi mjekun tuaj ose 1813 në situatat e mëposhtme:

- Ju keni simptoma të COVID-19 dhe ndiheni aq të sëmurë sa dëshironi të flisni me një mjek
- Jeni të shqetësuar ose keni dyshime
- Kur duhet ta testoni një fëmijë nën 2 vjeç.

Ju gjithashtu duhet të testoheni nëse jeni në kontakt të ngushtë me një person të infektuar. Kontaktet e ngushta janë zakonisht ata me të cilët jetoni dhe flini, por mund të jenë edhe kolegë dhe miq me të cilët keni qenë afër.

Dhe ju duhet të testoheni, nëse ju kërkohet ta bëni një gjë të tillë. Kjo mund të jetë, për shembull, në lidhje me shtrimin në spital, trajtimin ose ekzaminimin, ose si pjesë e zbulimit të infeksionit në rast të një shpërthimi në, për shembull, shkollë, zona banimi ose vende pune.

Si të merrni rezultatin e testit

Ju duhet të identifikoheni në sundhed.dk me NemID për të marrë rezultatin e testit.

Nëse jeni të infektuar me COVID-19, shkruan se testi është 'Positiv', 'Formodet positiv' ose 'Påvist'. Nëse jeni të infektuar, është shumë e rëndësishme që të shkoni në izolim në mënyrë që të mos infektoni të tjerët.

Nëse nuk jeni të infektuar me COVID-19, shkruan se testi është 'Negativ' ose "Ikke påvist".

Lexoni më shumë rreth COVID-19 në coronasmitte.dk

Nëse keni pyetje në lidhje me COVID-19, mund të telefononi gjithashtu në linjën e përbashkët të autoriteteve në tel. 7020 0233.